



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 173 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KAPITENERIA E PËRGJITHSHME
PORTEVE
Nr. 110 Prot.

06. 07. 2004.

AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt-marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve, i cili më poshtë do të quhet **KPP**, i përfaqësuar nga Kapiteni i Përgjithshëm i Porteve, z. Hiqmet Hima.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt marrëveshje, me qëllim: realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. KPP anagazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive cdo informacion apo të dhënë që disponon ky institucion dhe ato të vartësisë, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

3. KPP do të caktojë një strukturë të posacme si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. Në kërkesë duhet të jepen në mënyrë të qartë dhe të plotë identiteti dhe gjeneralitet e subjektit për të cilin kërkohet informacion. KPP merr përsipër që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

5. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



**KAPITENERIA E PËRGJITHSHME
E PORTEVE**

Kapiteni i Përgjithshëm

HIOMET HIMA

